



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

**Nr. 38 Akti**

**Nr. 36 Vendimi**  
**Tiranë, më 12.07.2018**

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Olsi Komici**  
**Brunilda Bekteshi**  
**Lulzim Hamitaj**

Kryesues  
Relatore  
Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Denisa Kosta, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në Tiranë, në datat 10.07.2018, ora 14:30 dhe 12.07.2018, ora 11:30, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Z. Kostaq Dhimitër Beluri**, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar; pasi shqyrtoi dhe bisedoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit Kostaq Beluri, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 12.07.2018 kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Z. Kostaq Dhimitër Beluri është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e në vijim referuar si “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtuar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit”, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (më poshtë referuar si “Komisioni”).

Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues administroi:

- Raportin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31- 33 të ligjit nr. 84/2016 të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim referuar “ILDKPKI”);
- Raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim referuar “DSIK”);
- Raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016 nga Prokuroria e Përgjithshme (këtu e në referim “PP”);

Me vendimin nr. 1, datë 14.12.2017, trupi gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues, z. Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

Më datë 14.05.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D dhe E të Aneksit të Kushtetutës,

si dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

Më datë 15.06.2018, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit: (i) mbi rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më datë 19.06.2018, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë përmes postës elektronike për t'u njohur me materialin "sekret", përmbajtjen e CD-së që Komisioni kishte siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Më datë 22.06.2018, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

Më datë 28.06.2018 Komisioni, pas deklasifikimit të materialit "sekret", njoftoi subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me përmbajtjen e CD-së.

Më datë 29.06.2018, subjekti i rivlerësimit depozitoi shpjegime shtesë lidhur me materialin filmik dhe fotografitë që Komisioni dispononte nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Më datë 04.07.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3 vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 10.07.2018, ora 14:30, pranë Pallatit të Kongreseve, kati i 2-të, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca u zhvillua në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe vëzhguesi ndërkombëtar.

Subjekti i rivlerësimit depozitoi pranë Komisionit parashtrimet e tij, me shkrim, në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ dhe dokumentacion, të cilat ishin të njëjta me ato të dërguara pas kalimit të barrës së provës. Në përfundim të parashtrimeve dhe përgjigjeve të pyetjeve të bëra, subjekti i rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Kostaq Beluri. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 10.07.2018, për të rifilluar më datë 12.07.2018, për shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Kostaq Beluri ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, (d) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga PP-ja, (e) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenin 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ë) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (f) denoncimet nga publiku; (g) faktet e njohura botërisht.

#### **A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË**

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, duke dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2017, raportin lidhur me vlerësimin e pasurisë, ku konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Kostaq Beluri:

- ka dhënë deklarime të sakta në përputhje me ligjin;
- ka vërtetuar ligjshmërinë e burimeve financiare;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

#### **Rivlerësimi i pasurisë/ Hetimi i kryer nga Komisioni**

Komisioni, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, për vlerësimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konfliktin e interesit, në referim të dispozitave ligjore nr. 84/2016, sipas të cilave procesi i hetimit administrativ bazohet në nenin 45, “Rregullat e përgjithshme të hetimit të çështjes”: *“Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni mund të kërkojë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.”*

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi: në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive në pronësi, përdorim, deklarimeve të rremë apo konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

**Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016.**

Apartament banimi nr. \*\*\*, në pallatin \*\*\*, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” (ish-Rr. “\*\*\*\*”), Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë, me sipërfaqe totale 141 m<sup>2</sup>, e ndarë në dy njësi banimi (nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*), ku subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se posedon 63 m<sup>2</sup>, plus 4 m<sup>2</sup>, si sipërfaqe e përbashkët me personin tjetër të lidhur - shtetasi M.M., për të cilin deklarohet se posedon 66.7m<sup>2</sup>, si pjesë e veçuar (ndarë) nga apartamenti me të njëjtin numër (\*\*\*), me sipërfaqe 141 m<sup>2</sup> (më poshtë, në analizën e këtyre fakteve shpjegohen motivet dhe mekanizmi i kësaj ndarjeje). Burimi i krijimit: Paga vjetore 1998; Vlera e investuar: 1.100.000 lekë; Pjesa takuese: 100 %.

Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:

-Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.07.2017, “Për trajtim e dërgim informacioni” - drejtuar ALUIZNI-t “Tirana 2”;

-Aktmarrëveshje (noteriale) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.01.2015, mes z. Kostaq Beluri dhe z. M.M., për kalimin e të drejtave reale;

-Kontratë porosie individuale, datë 7 nëntor 1997, mes z. Kostaq Beluri dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me vërtetim noterial nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.11.1997, shoqëruar me një planimetri të banesës (pa autor), si dhe një plan rievrimi të objektit, ku është bërë shtesa pa leje;

-Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.08.2017, “Kthim përgjigje dhe dërgim dokumentacioni” -deklaratë për përfshirjen në procedurat e legalizimit, për ndërtim informal në Rr. “\*\*\*\*”, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë - pa subjektet e tjera të lidhura; shoqëruar me: deklaratë (për legalizim ndërtimi informal) me nënshkrim të Kostaq Belurit, regjistruar me nr. \*\*\* prot., datë 22.01.2015 (1 fq.), certifikatë familjare (trungu i Kostaq Belurit) (1 fq.), fotokopje e kartës së identitetit të Kostaq Beluri (1 fq.).

-Shkresë (pa nr. prot.), datë 10.10.2016, “Vërtetim” - për pagën neto, periudha janar 1994 - dhjetor 1999 dhe janar 1999 - tetor 2004.

***Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, kërkoi dhe administroi:***

-Shkresën e ZVRPP-së Tiranë -përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.01.2018, përmes së cilës u administrua informacion lidhur me transaksionet imobilare (shitblerje të pasurive të ndryshme të paluajtshme) të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit M.M.

-Shkresën e Drejtorisë së ALUIZNI-t “Tirana-2”, nr. \*\*\* prot., datë 15.01.2018, përmes së cilës konfirmohet deklarimi/aplikimi nga ana e subjektit të rivlerësimit për legalizim të apartamentit nr. \*\*\*, p. \*\*\* dhe deklarimi për legalizim të apartamentit nr. \*\*\*, p. \*\*\*, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”.

-Shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. \*\*\* prot., datë 08.02.2018, përmes së cilës në pallatin nr. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*” (aktualisht adresa Rr. “\*\*\*\*”) konfirmohen pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

- Ap. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\* -bashkëpronarë: “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe Gjykata e Apelit (bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme);
- Ap. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\* -bashkëpronarë: E.M.O. dhe J.K.O. (bashkëlidhur, vërtetim pronësie, kontratë shitblerjeje, planimetri, planvendosje, kartela e pasurisë së paluajtshme);
- Ap. \*\*\*, pasuria nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\* -bashkëpronarë: “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe Gjykata e Apelit (bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme).

-Shkresën e Njesisë Administrative Nr. \*\*\*, Tiranë, nr. \*\*\* prot., datë 03.01.2018, përmes së cilës informohemi me të dhënat e ndërlidhësit në komunitet (Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*).

-Deklaratën datë 07.02.2018, nga shtetasi P.II. (ndërlidhësi në komunitet), përmes së cilës u konfirmuan emrat e banorëve të pallatit \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”- përmendet familja Beluri, por nuk përmendet emri i M.M.

-Deklaratën datë 07.02.2018, nga shtetasi H.D. (administrator i p. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”) -lidhur me pagesat efektive të shpenzimeve të njëjste të përbashkëta të pallatit, ku konfirmohet se këto pagesa kryhen nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shtetasi M.M., por në banesën e këtij të fundit banon një tjetër shtetas.

-Shkresën e Ujësjiellës-Kanalizimeve Tiranë, nr. \*\*\*prot., datë 11.01.2018, ku konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka kontratë me këtë shoqëri që nga viti 2004.

-Shkresën e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, nr. \*\*\* prot., datë 11.01.2018, përmes së cilës informohet se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasi M.M. kanë kontrata furnizimi me energji elektrike.

-Shkresën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmes së cilës informohet mbi komunikimin e akteve (pjesërisht të ndodhura) lidhur me ndërtimin e këtij pallati, si më poshtë:

-Vendimin nr. 6845, datë 14.08.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me paditës H.M., kundër të paditurës Bashkia Tiranë dhe personit të tretë, Enti Kombëtar i Banesave (*kundërshtim leje ndërtimit në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.*);

-Vendimin nr. 695, datë 13.02.1997, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me paditës Gjykatën e Apelit Tiranë kundër Njësisë Administrative Nr. \*\*\*, Bashkia Tiranë (kundërshtim i urdhrat administrativ të datës 15.01.1997);

-Aktet në dosjen gjyqësore të vendimit nr. 5820, datë 14.11.1997, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me kërkuese Gjykata e Apelit Tiranë, person i tretë Bashkia Tiranë (për vërtetimin e faktit juridik të ndërtimit të pallatit nr. \*\*\*, në Rr. “\*\*\*\*”, me \*\*\* kate, \*\*\* apartamente tre plus një dhe \*\*\* apartamente dy plus një).

### **Përmes postës elektronike të Komisionit, subjekti dha deklarime në lidhje me:**

-Marrëdhënien e tij me shoqërinë e ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k. \*\*\*, si dhe me shtetasin P.A. (përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. \*\*\*, si dhe marrëdhënien e tij me shtetasin me initiale M.M., për të cilat subjekti dha deklarimet e tij të shoqëruara me dokumentacion.

- Qëllimin e ndarjes së apartamentit nr. \*\*\* në dy njësi banimi<sup>1</sup>, si dhe shkakun që e pengoi për të nënshkruar aktin përfundimtar për kalimin e pronësisë me palën pronare, si dhe mbi burimin e ligjshëm të financimit të shumave në mandatet e arkëtimit nr. \*\*\*, datë 07.11.1997 (M. M. paguan 8.450 USD); nr. \*\*\*, datë 17.03.1998 (M. M. paguan 2.000 USD) dhe nr. \*\*\*, datë 16.05.1998 (M. M. paguan 1.500 USD).

-Mbi shpenzimet mujore në periudhën 1992 - 2000.

Gjithashtu, Komisioni kreu edhe analizën financiare me qëllim vlerësimin e faktit, nëse subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura të mjaftueshme për krijimin e likuiditetit prej 1.100.000 lekësh (ose 9.450 USD -sipas subjektit).

**Trupi gjykues i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës** për të provuar të kundërtën, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë rezultuan dyshime të arsyeshme për:

---

<sup>1</sup> Kanë nisur të realizohen që në fazën e ndërtimit të apartamentit.

- ✓ Nuk kishte pasur të ardhura/kursime të mjaftueshme për krijimin e likuiditetit në vlerën 8.450 USD në vitin 1997, për ndërtimin e apartamentit nr. \*\*\*, p. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*” (ish-“\*\*\*\*”), Tiranë. Në konstatimin e arritur, Komisioni i vuri në dispozicion subjektit metodologjinë e përdorur dhe analizën e kryer të pasqyruar në tabelën e mëposhtme lidhur me të ardhurat e krijuara për të justifikuar këtë pasuri/likuiditet 1 janar 2007 -7 qershor 2007 (muaji kur ishte kryer pagesa).

Analiza financiare pasqyron pagesën sipas mandatarkëtimit më datë 6.11.1997 prej 8.450 USD, ose 983.597 lekësh (të konvertuara me kurs këmbimi 116.4 lekë/USD, sipas deklarimit të subjektit të vlerës së apartamentit 1100000/9450 USD, në raport me të ardhurat e realizuara, ndryshimin e pasurisë, shpenzimet jetike, sipas të cilave rezulton:

-Të ardhurat neto nga pagat për vitet 1988 - 1993, të pasqyruara në mënyrë analitike sipas tabelës së mëposhtme, ishin në vlerën 820.118 lekë.

Vitet	Pagat referencë 1988-1993 (lekë në muaj)	Të ardhura bruto	Të ardhura neto
1988	680	8.160	8.160
1989	680	8.160	8.160
1990	700	8.400	8.400
1991	700	8.400	8.400
1992	1.400	16.800	16.800
1993	1.400	16.800	16.800
1994			138.718
1995			180.174
1996			212.902
1997			221.604
	<b>TOTALI</b>		<u>820.118</u>

Në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve jetike për këtë periudhë, në kushtet që Komisioni nuk ka referenca dhe standarde nga Instituti i Statistikave dhe nga ILDKPKI-ja, në përllogaritjen e shpenzimeve jetike u mbajtën në konsideratë shpenzimet e kryera në raport me të ardhurat vjetore dhe se subjekti i rivlerësimit në këto vite ka jetuar me prindërit, duke deklaruar se ka kryer vetëm shpenzime personale, si më poshtë:

-Për periudhën 1988-1991 janë llogaritur me 500 lekë në muaj shpenzime personale.

-Për periudhën 1992-1997 janë llogaritur 1.000 lekë në muaj shpenzime personale.

-Analiza financiare e aftësisë pagueuse në raport me të ardhurat e realizuara, ndryshimin e pasurisë, shpenzimet jetike, rezulton:

	<b>ANALIZA FINANCIARE</b>	<b>Viti 1988-1997</b>
1	Të ardhurat	820.118
2	Ndryshimi i pasurisë (8.450 USD)	983.597
3	Shpenzime të deklaruara	0
4	Shpenzime jetike	96.000
	<b>Diferenca (shpenzime më shumë se të ardhura)</b>	<b>-259.479</b>

**1.3 Ndërsa subjekti i rivlerësimit, më datë 22.06.2018, dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij<sup>2</sup>, -si dhe në seancën dëgjimore të datës 10.07.2018, - ndër të tjera, për këtë pasuri është shprehur se:**

- Analiza financiare për rastin e arkëtimit të shumës prej 8.450 USD nuk është e saktë, duke pasur parasysh referencat në kursin e këmbimit ditën që është bërë arkëtimi.
- Komisioni i referohej kursit të këmbimit të dollarit amerikan me lekë, në kohën që është arkëtuar shuma prej 8.450 USD, si këst i parë për apartamentin, datë 06.11.1997.
- Shuma prej 1100.000 lekësh, si konvertim i shumës prej 9.450 USD, ishte një përlllogaritje e përafërt e bërë nga ana e tij, me qëllim për ta shprehur në deklaratën e pasurisë vlerën në lekë të apartamentit, dhe duke iu referuar kursit të këmbimit në kohën që është bërë deklarata, por kjo shumë nuk shprehte në mënyrë të saktë shpenzimet faktike që janë bërë për këstin e parë të apartamentit.
- Pagesa për këstin e parë të apartamentit në shumën 8.450 USD ishte realizuar nga kursimet në vite nga të ardhurat e ligjshme, të cilat, për të qenë më të sigurta, janë konvertuar me kursin e këmbimit më të favorshëm të kohës.
- Kursi i këmbimit nga lekë në dollarë, nga viti 1990 deri në vitin 1997, sipas Arkivit të Bankës së Shqipërisë, rezulton se ka qenë shumë më i favorshëm para vitit 1997 dhe ka variuar nga 1 USD me 0.14 lekë deri në 1 USD me 148.93 lekë në vitin 1997, duke e shoqëruar me një evidencë të kursit mesatar të këmbimit sipas Arkivit të Bankës së Shqipërisë.
- Referuar kursit të këmbimit në vite, shuma prej 8.450 USD, e arkëtuar në datën 06.11.1997, justifikohet me kursimet e tij në shumën 724.118 lekë.

#### **1.4 Arsytimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**Në lidhje me ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie për blerjen e këtij apartamenti, si dhe mjaftueshmërinë e të ardhurave:**

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si pasuri apartamentin nr. \*\*\*, në katin e \*\*\*, p. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, sipas kontratës së porosisë individuale, datë 07.11.1997, vërtetuar me mandatet e arkëtimit nr. \*\*\* të datës 06.11.1997 (paguar 8.450 USD) dhe mandatin e arkëtimit nr. \*\*\* të datës 14.03.2000 - (paguar 1.000 USD).

<sup>2</sup>Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.



Sa i përket mënyrës së përmbushjes së detyrimit të pagesës referuar kontratës së porosisë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit duhet t'i paguante sipërmarrësit shumën prej 28.200 USD, pagesa të cilat parashikoheshin të kryheshin me këste, kësti i parë prej 8.450 USD duhej paguar më datë 20.01.1997.

Sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, më datë 06.11.1997 -një ditë para nënshkrimit të kontratës, rezulton se është paguar shuma 8.450 USD e cila cilësohet në mandat si kësti i parë dhe i dytë. Pra, në dukje, hiqet nga detyrimi një këst me të njëjtën shumë (8.450 USD), për pasojë, kontrata pëson pakësime në të drejta dhe detyrime të ndërsjella mes palëve, pasi zbritet esencialisht çmimi dhe sipërfaqja.

Më datë 14.03.2000, sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, të datës 14.03.2000, rezulton të paguhet shuma 1.000 USD. Mbi pagesën e diferencës së çmimit, subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion, kopje të njësuara me origjinalin të pagesave, -mandatarkëtimet nr. \*\*\*, datë 07.11.1997 (8.450 USD); nr. \*\*\*, datë 17.03.1998 (2.000 USD) dhe nr. \*\*\*, datë 16.05.1998 (1.500 USD), total 11.950 USD, të kryera nga shtetasi M.M. për llogari të shoqërisë së ndërtimit.

Më datë 23.01.2015, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një aktmarrëveshje (për kalim pjesor të të drejtave reale të kontratës së porosisë, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.11.1997, mes tij dhe shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k.) me personin tjetër të lidhur, shtetasin M.M.

Në bazë të kësaj aktmarrëveshjeje pasqyrohet një deklaram i përbashkët mbi një raport juridik të krijuar më herët mes tyre (që në vitin 1997) mbi apartamentin e porositur nga subjekti, të vërtetueshëm me mandatet e pagesës, por të paformalizuar në mënyrë shkresore.

Subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion, -kopje të njësuara me origjinalin të pagesave, -mandatarkëtimet nr. \*\*\*, datë 07.11.1997 (8.450 USD); nr. \*\*\* datë 17.03.1998 (2.000 USD) dhe nr. \*\*\*, datë 16.05.1998 (1.500 USD), total 11.950 USD, -të kryera nga shtetasi M.M. për llogari të shoqërisë së ndërtimit.

Në analizë të rrethanave të mësipërme, deri në nënshkrimin e aktmarrëveshjes të datës 23.01.2015, nuk gjendet asnjë titull ligjor/juridik i formalizuar shkresërisht, në bazë të të cilit nga shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k. dhe/ose subjekti i rivlerësimit të kalonin të drejta reale apo edhe kreditë në favor të shtetasit M.M., për gjysmën e sipërfaqes së apartamentit nr. \*\*\* në p. \*\*\*, Rr. "\*\*\*\*" (me sip.141 m<sup>2</sup>), që në thelb, *de jure* dhe *de facto*, njëkohësisht pakëson të drejtat ose kreditet e porositësit përballë shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k.

Por, kjo situatë juridike e paqartë rregullohet me aktmarrëveshjen e datës 23.01.2015, përmes së cilës sqarohet edhe shkaku i pjesëmarrjes së personit tjetër të lidhur, z. M.M., si investitor me interes të veçuar, në raport me pagesat për pjesën e pretenduar prej tij në apartamentin e porositur fillimisht nga subjekti i rivlerësimit.

### **Për pasojë, Komisioni lidhur me ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie, çmon se:**

Në mungesë të provave për një raport juridik të vlefshëm, pagesat e subjektit të rivlerësimit dhe të personit tjetër të lidhur, z. M.M., në investimin për ndërtimin e apartamentit nr. \*\*\* në p. \*\*\*, Rr. "\*\*\*\*", Tiranë, mbeten thjesht kreditime në favor të personit tjetër të lidhur, "\*\*\*\*" sh.p.k., për të mundësuar mbulimin e të gjithë detyrimit financiar ndaj kësaj shoqërie, për përfundimin e të gjithë sipërfaqes ndërtimore prej 141 m<sup>2</sup>.

Pretendimet pronësore pa financiare mbi ndërtimin e realizuar (secili për pjesën përkatëse të veçuar, sipas planimetrisë dhe aktmarrëveshjes datë 23.01.2015), mbeten çështje juridike mes palëve të angazhuara të subjekteve të sipërcituara, si dhe të institucionit të ALUIZNI-t "Tirana 2",

që i janë drejtuar që të dy personat e interesuar për legalizimin e tërë sipërfaqes së ndërtimit të paguar prej tyre, prej 141 m<sup>2</sup>.

✓ Lidhur me pamjaftueshmërinë e të ardhurave në shumën *minus 259.479 lekë*, trupi gjykues arsyeton se, duke qenë se periudha e blerjes së apartamentit rezulton përpara se subjekti i rivlerësimit të bëhej subjekt deklarues, Komisioni:

- Nuk ka referencë për të verifikuar gjendjet në *cash* të kursimeve të tij në fund të çdo viti, në vlerë apo monedhë *lekë, USD, euro*, për ta analizuar atë sipas kursit të këmbimit.

-Nuk ka referenca dhe standarde nga Instituti i Statistikave dhe nga ILDKPKI-ja në përlllogaritjen e shpenzimeve jetike<sup>3</sup>, nisur edhe nga parimi i proporcionalitetit e çmon atë si një “pasaktësi” në deklarimin e vlerës në lekë të deklaruar nga ana e tij.

**2. Lidhur me pasaktësitë e konstatuara për mosdeklarimin** në deklaratën periodike vjetore të depozitës bankare pranë “Credins Bank”, të krijuar më 31.07.2013, si dhe mosdeklarimin e gjendjes së llogarisë rrjedhëse të pagës në fund të viteve 2005 - 2016, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij<sup>4</sup>, ndër të tjera, është shprehur se:

- Kishte vlerësuar se në deklaratën periodike duheshin deklaruar ndryshimet (shtesa apo pakësime) në pasuri. Krijimin e depozitës me të ardhurat e llogarisë rrjedhëse të pagës në njëjtën bankë, nuk e kishte vlerësuar si ndryshim në pasuri dhe si detyrim për t’u deklaruar. Në deklaratën periodike të vitit pasardhës kishte deklaruar interesin e përfituar nga kjo depozitë si shtesë në pasurinë e tij, për pasojë rezulton e deklaruar vetë depozita.
- Lidhur me mosdeklarimet në deklaratat periodike të gjendjeve në fund të vitit për llogarinë rrjedhëse të pagës, “*statment-eve* bankare”, nuk e kishte vlerësuar se kishte qenë e nevojshme, përderisa kishte deklaruar të gjitha të ardhurat e tij të ligjshme, të cilat kishin kaluar nëpërmjet kësaj llogarie bankare.

### **2.1 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

Bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” të ndryshuar, ku është parashikuar se: “*Në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë, të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji, ata të lindur gjatë vitit që deklarohet dhe çdo e ardhur e fituar dhe shpenzim i deklarueshëm, i kryer gjatë gjithë vitit për të cilin bëhet deklarimi.*”, subjekti i rivlerësimit duhej të pasqyronte saktë çdo ndryshim të pasurisë së tij.

**Lidhur me këto konstatime, trupi gjykues i ka vlerësuar si pasaktësi, pasi subjekti i rivlerësimit:**

-Ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e depozitës dhe, nga ana tjetër, ai ka deklaruar interesat bankare të saj.

<sup>3</sup> Në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve jetike, u mbajtën në konsideratë shpenzimet e kryera në raport me të ardhurat vjetore, dhe faktin se subjekti i rivlerësimit në këto vite ka jetuar me prindërit;

<sup>4</sup>Referojuni parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në dosje.

-Likuiditetet në llogarinë bankare të padeklaruara në fund të viteve nga ana e subjektit, janë tërësisht të justifikuara me burime të ligjshme të deklaruara nga subjekti (të ardhurat nga pagat, honorarët dhe mësimdhënia).

**Si konkluzion, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer vetëm deklarime të pasakta, arrin në përfundimin se ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.**

## **B. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, i deklasifikuar me vendim të KDZH-së, nr. \*\*\*, datë 08.01.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Kostaq Beluri.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Grupi i Punës ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Nuk rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016.**

## **C. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KRITERIT ETIKO-PROFESIONAL**

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme;
- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Për këtë, ky institucion ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2017, “Raport për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Kostaq Beluri”, në prezencë të një anëtari të Komisionit të përzgjedhur me short, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

Prokuroria e Përgjithshme, në vlerësimin e saj është bazuar në: Formularin e vetëdeklarimit; 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë. Ky institucion, në përshkrimin e 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, ka konstatuar se:

### **Aftësitë profesionale**

#### **a) Njohuritë ligjore**

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, ka rezultuar se z. Kostaq Beluri është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar më datë 03.11.2017 në Prokurorinë e Tiranë, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, ka rezultuar se: Subjekti i rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural.

#### **b) Arsytimi ligjor**

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, z. Kostaq Beluri është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar më datë 03.11.2017 në Prokurorinë e Përgjithshme për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore, për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, ka rezultuar se: Subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej tij kanë shtjellim të kuptueshëm. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Përgjithësisht, përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje pretendimeve të palëve.

### **Aftësitë organizative**

#### **a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë**

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, z. Kostaq Beluri është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi dhe shpejtësi.

Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 03.11.2017 në Prokurorinë e Përgjithshme, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse, si dhe:

Subjekti i rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me shpejtësi, pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezultojnë se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë organizative të treguara prej tij, pasi ka përballuar ngarkesë pune voluminoze me cilësi dhe shpejtësi.

Nga gjetjet në procedimet penale të përzgjedhura në shortin e zhvilluar lidhur me subjektin, rezultojnë se: Në të gjitha procedimet penale janë kryer në çdo rast procedurat e njoftimit të akteve të prokurorit për palët pjesëmarrëse. Po kështu, për këto procedura nuk rezultojnë të ketë pasur kontestime apo ankesa prej tyre.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga gjetjet në dokumentin ligjor të përzgjedhur në shortin e zhvilluar në datën 03.11.2017, në Prokurorinë e Përgjithshme, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, dhe që lidhet në këtë raport me dosjen nr. \*\*\* (juridiksion fillestar), rezultojnë se: Në procedimin penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë së Përgjithshme, ku subjekti ka kryer funksionin e prokurorit të çështjes, nga ana e subjektit janë lënë detyra të hollësishme dhe të detajuara për oficerët e Policisë Gjyqësore, të cilët janë orientuar në mënyrë të qartë për hetimet që duhet të kryeshin. Prokurori i çështjes ka kryer disa veprime hetimore.

Kur subjekti ka pasur rolin e kontrollit të hetimeve (shiko dosjen nr. \*\*\*), ai ka evidentuar me hollësi mangësitë e konstatuara në hetimet e kryera dhe, po kështu, ka lënë detyra të hollësishme në formë orientimesh për hetimet e mëtejshme, fakt që flet për një studim paraprak të thelluar dhe administrim i çdo të dhëne të rëndësishme në aktet e procedimeve penale përkatëse.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

a) Etika në punë

Në lidhje me vlerësimin e etikës në punë, nga vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, është vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale.

b) Integriteti

Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti, për subjektin e rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth cenimit të integritetit të tij.

c) Paanësia

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin e rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, për periudhën objekt vlerësimi, nuk rezultojnë të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jenë diskutuar cenim i të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerable.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

a) Aftësitë e komunikimit

Në lidhje me vlerësimin e aftësive komunikuese, nga vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, z. Kostaq Beluri është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e komunikimit.

### **Aftësia për të bashkëpunuar**

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, z. Kostaq Beluri është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

#### a) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi të subjektit të rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, rezulton të jetë angazhuar në një sërë aktiviteteve profesionale të organizuara, të tilla si:

- Ka marrë pjesë si ekspert në Shkollën e Magjistraturës;
- Ka marrë pjesë në seminarët e organizuara nga “PAMECA” gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të vitit 2015, me temë “Prezantimi i praktikave më të mira mbi hetimin e krimit financiar”;
- Në vitin 2016 ka marrë pjesë si moderator në trajnimin e organizuar nga “TAIEX” në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme, me temë “ Për forcimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar”.

### **RIVLERËSIMI I KRITERIT ETIKO-PROFESIONAL NGA KOMISIONI**

Trupi gjykues, lidhur me këtë kriter, ka hetuar në mënyrë të pavarur nga institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme mbi dosjet e përzgjedhura me short për çështjen e mëposhtme:

- Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 08.08.2016, i Prokurorisë së Përgjithshme. Kjo dosje në këtë raport përmban vetëm procedimin penal, pasi dokumenti ligjor i shortuar ishte vetë procedimi penal, ku subjekti kishte kryer funksionin e prokurorit të çështjes.

Grupi i Punës i Prokurorisë, në raportin për vlerësimin e aftësive profesionale, të dërguar pranë Komisionit, ka konstatuar se<sup>5</sup>:

*“Në procedimin penal nr. \*\*\* të Prokurorisë së Përgjithshme, ku subjekti ka kryer funksionin e prokurorit të çështjes, rezulton se hetimet janë kryer sipas afateve që parashikon neni 323.1 i Kodit të Procedurës Penale”.*

Në këtë procedim rezulton se janë kryer në çdo rast procedurat e njoftimit të akteve të prokurorit për palët pjesëmarrëse dhe, po kështu, për këto procedura nuk rezulton të ketë pasur kontestime apo ankesa prej tyre. Në procedimin penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë së Përgjithshme, ku subjekti ka kryer funksionin e prokurorit të çështjes, rezulton se nga ana e subjektit janë lënë detyra të hollësishme dhe të detajuara për oficerët e Policisë Gjyqësore, të cilët janë orientuar në mënyrë të qartë për hetimet që duhet të kryheshin. Prokurori i çështjes ka kryer disa veprime hetimore.

#### ➤ **Shqyrtimi i materialeve të dosjes penale nga trupi gjykues:**

Ky vendim është përpiluar dhe nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga aktet e këtij procedimi rezulton se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë 02.02.2016, për veprat penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal. Me vendimin e datës 01.04.2016 është shpallur moskompetenca lëndore dhe dosja hetimore i është dërguar Prokurorisë së Përgjithshme. Me

---

<sup>5</sup> Refero raportin e Prokurorisë së Përgjithshme, faqe 20.

urdrin e datës 08.04.2016 të prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e akteve dhe marrjen përsipër të hetimit, duke regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 08.04.2016, për veprat penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve L.H. dhe A.Th.

Në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprimet hetimore:

- Ka administruar aktet e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
- Ka marrë deklarime, si persona që tregojnë rrethana të hetimit, nga dy punonjësit e Policisë, që kanë kryer vëzhgimin në vende publike.
- Ka marrë deklarime nga gjyqtari që ka vlerësuar dhe caktuar masën e sigurimit për shtetasin Sh.B., si dhe deklarime nga shtetas që kanë kontaktuar me shtetasen L.H.
- Ka marrë informacion nga shoqëritë telefonike për numrat e telefonit në përdorim të subjekteve nën hetim, si dhe tabulatet për bisedat e kryera për periudhën e kohës në interes të hetimit.
- Ka administruar në CD pamjet filmike për përgjimin në ambiente publike të shtetases L.H. dhe shtetasit A.Th.
- Ka kryer këqyrje të pamjeve filmike që shoqërojnë procesverbalin e përgjimit në vende publike.
- Ka pyetur si persona ndaj të cilëve zhvillohen hetime shtetasit L.H. dhe A.Th.

✓ Më datë 29.07.2016, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016, bazuar në nenin 328/1, germa “b”, të Kodit të Procedurës Penale.

### **Rivlerësimi i trupit gjykues për çështjen**

Trupi gjykues ka konstatuar se konkluzionet e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme nuk përputhen me veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të hetimit të procedimit penal nr. \*\*\*.

Grupi i Punës së Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë vlerësimit të kësaj çështjeje ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka lënë detyra të hollësishme dhe të detajuara për oficerët e Policisë Gjyqësore, të cilët janë orientuar në mënyrë të qartë për hetimet që duhet të kryheshin. Bazuar në aktet e administruara në dosje, konstatimet e Komisionit dhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton që subjekti të kishte lënë detyra të hollësishme dhe të detajuara për oficerët e Policisë Gjyqësore, të cilët janë orientuar në mënyrë të qartë për hetimet që duhet të kryheshin. Në këtë pikë, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit i ka kryer vetë veprimet hetimore.

Trupi gjykues vlerëson se Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme, në vlerësimin mbi përmbajtjen e dosjes penale nr. \*\*\*, u është referuar vetëm veprimeve të kryera nga ana e prokurorit, pa analizuar mangësitë e kësaj dosjeje, sikurse janë konstatuar nga hetimi i Komisionit.

Trupi gjykues, referuar hetimit të kryer për këtë çështje, bazuar në aktet e administruara në dosjen penale, ka konstatuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit janë kryer hetime por, nga ana tjetër, vlerëson se nga ana e tij duhej të ishte ndjekur logjika për shtrirjen e hetimit edhe në drejtime të tjera.

Mangësitë konsistuan në:

1. Mospërfundimi i veprimeve hetimore, moszgjerimi i rrethit të personave që kishin dijeni mbi rrethanat e çështjes, të atyre të dyshuar se mund të kishin kryer veprën penale, si dhe mosanalizimi i deklarimeve që ndodhen në dosje, duke evidentuar:

- mungesën e hetimit të thelluar mbi një numër telefonik (formalisht në emër të një shtetaseje të seksit femër);
- mosçmuarjen e përgjimeve telefonike të personave nën hetim me persona të tjerë që lidhen me ta;
- mosbërjen e ballafaqimit, si dhe moskërkimin e sqarimeve nga personi nën hetim (L.H.) dhe as nga persona të tjerë që kishin dijeni mbi rrethana të dobishme (G.P.) mbi kuptimin e bisedave të kriptuara;
- mosbërjen e hetimit/analizë pasurore/financiare e pasurive dhe llogarive të personave nën hetim;
- mosshtrirjen e hetimit te dy të afërmit e personit nën hetim, L.H.;
- mosshtrirjen e hetimit mbi bisedat telefonike të gjyqtarit të masës së sigurimit personal;
- lënia jashtë përgjimit, para dhe pas marrjes së deklarimeve, të personave të dyshuar.

2. Mospërdorimi i mekanizmave proceduralë që shuajnë kontradiktat në materialet e dosjes, siç mund të ishin ekspertiza, ballafaqimet, hetimi proaktiv.

3. Mosshfrytëzimi i shërbimeve të specializuara të shtetit bazuar në dispozitat ligjore përkatëse, të nevojshme për të zbuluar fakte që nuk mund të realizoheshin me mjete të zakonshme të hetimit, siç mund të ishin Policia Shkencore apo veprimet operacionale të specializuara të Policisë së Shtetit.

### **Arsyetimi ligjor dhe rivlerësimi profesional**

Sipas dispozitave të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 84/2016: *“Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”*.

Pika 2 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 përcakton që: *“Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.*

Pika 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 përcakton që: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”*.



## **Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë<sup>6</sup>:**

- Nenin E, pika 1, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”;
- Nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”;
- Vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias);
- Nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë...”, **Arsyeton:**

## **Për mangësitë e konstatuara në dosjen penale nr. \*\*\*, të referuara sa më sipër, nuk rezultuan të dhëna/prova, që të provonin se ato ishin të paramenduara, si dhe nuk janë të mjaftueshme:**

- Për t’i çmuar ato si sjellje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e këtij prokurori (duke marrë në konsideratë trajtimin që ai ka bërë në dosjet e tjera);
- Për ta vlerësuar atë me mangësi profesionale; si dhe
- Nuk janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë /praktikë pune të papajtueshëm me pozicionin e tij.

Sa më sipër, si dhe për shkak të kufizimit<sup>7</sup> për të mos zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit, trupi gjykues çmon vetëm mangësitë e gjetura në dosje, duke vlerësuar se këto mangësi mund të përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor të tij, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Në përfundim, për kriterin e vlerësimit etiko - profesional, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

Sa i përket dosjes nr. \*\*\*, bazuar në nenin 40, pika 1, germa “c”, në nenin 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016, çmon ta transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim për shkelje disiplinore.

---

- <sup>6</sup> Pika 2, paragrafi 2, i tij: “Vlerësimi i aftësisë së prokurorit përfshin aftësinë për të hetuar, për të ngritur akuzën publike, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale bazuar në standardet e parashikuara në ligj”.

- Neni 40 i ligjit nr. 84/2016, “...objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etiko - profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe legjisllacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve e prokurorëve”.

<sup>7</sup> Bazuar në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

## **Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

Pasi u hetua në mënyrë të thelluar i) mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, ii) mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar iii) si dhe mbi vlerësimin e veprimtarisë etiko-profesionale, trupit gjykues i rezultoi se:

**Lidhur me kriterin e pasurisë**, duke analizuar gjetjet e mësipërme, konstatohet se ato janë vetëm pasaktësi, të cilat nuk kanë sjellë pasoja, që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të pajustificuara, deklarime të rremë apo fshehje të pasurisë. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, trupi gjykues konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.

**Lidhur me kriterin e figurës**, trupit gjykues nuk i rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko - profesional**, trupi gjykues çmon se mangësitë e konstatuara vetëm në një prej dosjeve të hetuara nga subjekti, janë të pamjaftueshme për t'i çmuar ato si cilësi të papranueshme në pune, gjykim të dobët. Në këtë drejtim, trupit gjykues nuk i rezultuan indice apo elemente në çështje të tjera, për të ngritur dyshime se subjekti ka një mënyrë/model pune të papajtueshëm me pozicionin e tij, as shkelje të respektimit të të drejtave të palëve.

Gjithashtu, trupit gjykues gjatë vlerësimit të aftësive etiko-profesional ndaj subjektit të rivlerësimit:

- ✓ nuk i rezultuan elemente që ta identifikonin atë me të meta apo probleme në gjykimin e rasteve të tjera individuale, të tilla si mosrespektim i afateve ligjore, referenca të gabuara ligjore, dosje të paplota, sipas neneve 72 - 74 të ligjit nr. 76/2016;
- ✓ nuk i rezultuan të dhëna apo gjetje negative nga regjistri i ankesave dhe procedimeve disiplinore;
- ✓ nuk rezultuan të dhëna negative lidhur me trajtimin e çështjeve sipas neneve 75, 76 të ligjit nr. 96/2016.

Në këto kushte, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues vlerëson se mangësitë e konstatuara vetëm në një rast, për subjektin e rivlerësimit, nuk janë të mjaftueshme për të arritur në vlerësimin e tij “me mangësi” ose si “i papërshtatshëm”. Sa më sipër, në konkluzionin përfundimtar trupi gjykues nuk mund të arrijë në një vlerësim tjetër për subjektin e rivlerësimit, përveçse: “I aftë”.

## **Konkluzioni përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, plotëson kushtet e mëposhtme:

- arrin nivel të besushëm në vlerësimin e pasurisë;
- arrin nivel të besushëm në kontrollin e figurës;
- arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë.
2. Me shumicë votash, transferimin e çështjes nr. \*\*\* pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ndaj këtij vendimi, me përjashtim të pikës 2, mund të kryhet ankim pranë Kolegjit të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Olsi Komici**  
**Kryesues**

**Lulzim Hamitaj**  
**Anëtar**

**Brunilda Bekteshi**  
**Relator**

**Sekretare gjyqësore**

**Denisa Kosta**

## MENDIM PAKICE

Si anëtar i trupit gjykues nuk pajtohem me përfundimin e arritur nga ana e kolegëve të shumicës (“shumica”) për transferimin e çështjes nr. 3/2016 pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, në rastin e shqyrtimit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, për arsytet e mëposhtme:

Për sa i takon konkluzionit që ka nxjerrë shumica – bazuar në aktet e administruara në dosjen penale nr. 3/2016 – se nga ana e subjektit të rivlerësimit janë kryer hetime por, nga ana tjetër, vlerëson se nga ana e tij duhet të ishte ndjekur logjika për shtrirjen e hetimit edhe në drejtime të tjera, mendoj se nuk qëndron.

Procedimi penal nr. 3/2016 është regjistruar mbi bazën e moskompetencës së shpallur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për procedimin penal nr.183/2016. Ky institucion ka pasur detyrimin ligjor që të përfshijë të gjitha aktet e nevojshme, që përfshijnë indice apo prova, në lidhje me veprën penale dhe subjektet për të cilat është kryer regjistrimi i procedimit penal.

Hetimi proaktiv për procedimin penal nr. 3/2016 është kryer nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në kuadër të procedimit të saj penal nr. 183/2016 dhe, pas identifikimit të subjektit të posaçëm, si të dyshuar, ka shpallur moskompetencën dhe aktet ia ka kaluar Prokurorisë së Përgjithshme e cila, mbështetur në Kodin e Procedurës Penale, ka pranuar aktet dhe ka regjistruar procedimin penal nr. 3/2016. Ky procedim penal i Prokurorisë së Përgjithshme nuk është një procedim i lidhur. Referuar kriterëve të parashikuara në nenin 306/2, germet “a”, “b”, dhe “c”, në rastin konkret nuk përmbushet asnjë nga kriteret që përcakton Kodi i Procedurës Penale për një procedim të lidhur.

Mangësitë e konstatuara nga shumica janë shpjeguar nga subjekti i rivlerësimit në sqarimet e tij, duke arsyetuar se në momentin kur Prokuroria e Përgjithshme është bërë kompetente për hetimin e këtij procedimi penal, nuk ka pasur më zhvillim dinamik të situatave të dyshimta dhe nuk është vlerësuar kryerja e veprimeve hetimore proaktive, pasi kishin kaluar dy muaj nga ndjekja në terren e situatave të dyshimta dhe interceptimeve telefonike të subjekteve në funksion të situatës.

Për një vlerësim të drejtë dhe objektiv të situatave të mbartura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, prokurori i çështjes ka vlerësuar kryerjen e veprimeve hetimore plotësuese, të cilat janë kryer me korrektësi dhe janë konstatuar edhe nga Komisioni.

Mangësitë e konstatuara nga Komisioni janë veprime që lidhen me hetimin proaktiv, i cili është kryer nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Në vendimin e pushimit për procedimin penal nr. 3/2016 ka nja analizë dhe arsyetim ligjor të rrethanave dhe provave të administruara në fashikullin e procedimit penal. Kontradiktat e pjesshme që kanë rezultuar në dosje janë vlerësuar pa rëndësi për hetimin.

Në lidhje me konkluzionin e arritur nga shumica për vlerësimin e kriterit etiko - profesional, se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal të vlerësimit të aftësive profesionale dhe për sa

i përket dosjes penale nr. 3/20016, çmon ta transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim për shkelje disiplinore, unë shprehem kundër dërgimit të dosjes për inspektim për shkelje disiplinore, pasi ajo duhet dërguar për inspektim mbështetur në standardet e vendosura në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe se duhet të ketë prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja disiplinore. Shkelja disiplinore duhet të vijë nga mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjit procedural ose material në kryerjen e veprimeve procedurale. Parashtrim i shtrembëruar i fakteve në aktet e nxjerra, apo nxjerrja e akteve të paarsyetuara.

Vlerësimi i fakteve dhe provave në çështjen e hetuar nga subjekti i rivlerësimit mendoj se nuk janë objekt i procedimeve disiplinore.

Ashtu siç edhe shumica ka arsyetuar, vlerësimi i aftësitë profesionale të prokurorit përfshijnë njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, dhe se:

(i) vlerësimi i aftësive ligjore mbështetet në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën;

(i) arsytimi ligjor mbështetet në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, e vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si: qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

Pika 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, parashikon se: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.”*

Për sa më sipër, shpreh bindjen e bazuar në prova, se subjekti i rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, nuk ndodhet në rastet e parashikuara nga neni 59/4 i ligjit nr. 84/2016. Niveli i konstatimeve në lidhje me shkaqet që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk plotësojnë kriteret dhe shkaqet që të përlligjin transferimin e çështjes pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

Në këto rrethana, duke pasur parasysh raportin e grupit të punës të Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësimin etiko - profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, provat e shqyrtuara dhe nga deklaratimet e bëra në seancën dëgjimore, krijoj bindjen se subjekti i rivlerësimit, z. Kostaq Beluri, ka krijuar një nivel të mjaftueshëm profesional, në vlerësim të të gjithë përbërësve të vlerësimit, krijoj bindjen se shumica nuk duhet të kish disponuar me transferimin e çështjes nr. 3/20016 pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas nenit 59/4 të ligjit nr. 84/2016.

**Olsi Komici**  
**Anëtar**

